

ANTI MOULD



PËRSHKRIMI

Bojë me rezistencë të lartë ndaj larjes së vazhdueshme dhe mykut, me bazë emulsioni PVA-VEOVA

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Sipërfaqe e lëmuar mat
- Mbulueshmëri e shkëlqyer
- Gjendet në 4 baza W, P, D dhe TR
- E pajisur me çertifikimin antibakterial
- Punueshmëri dhe nivelim shumë të mirë
- Ngjytje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Ndalon rritjen e mykut dhe mikro-organizmave
- Pranon 3200 cikle larjesh 30 ditë pas aplikimit

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, me bazë çimento, gëlqere, gips, dhe në çdo lloj ambienti të brendshëm, dhoma gjumi, tualete, dhoma ndenjjeje, ambiente zyresh, shërbimesh etj. Përdoret gjerësisht në ato ambiente ku ka nivele të lartë lagështie.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	PVA VEOVA Polimer
Densiteti EN ISO 2811-1	1,45±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	65%
Shkalla e hollimit	5-10%
Viskoziteti	110 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	4 - 6 ore
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.2
Aftësia mbuluese EN ISO 6504-3	≥ 99.5% klasa I
Rezistenca ndaj larjes ISO 11998	Klasa I

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjithmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Vox 707, Glatte Spachtel, ISO SPACHTEL ELASTISCH, etj. Më pas aplikohet Reninger 42 dhe lihet te veproje. Pas 30 minutash sipërfaqja pastrohet me ujë. Aplikojmë një shtresë të dytë me Reninger 42 dhe lihet të veprojë për 24 orë pasi sipërfaqja është tharë plotësisht aplikohet astari Macht Tiefgrund Wasser, i holluar me ujë në raportin 1:1. Gjatë aplikimit të astarit evitoni krijimin e një cipe e cila më pas krijon probleme në lidhjen e bojës me suportin.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Holloni produktin ANTI MOULD me 5-10% ujë, përveç bazave D dhe TR që nuk sugjerohen të hollohen më shumë se 5% ujë, duke u siguruar që të përziehet plotësisht me bojën. Përdorni një mikser elektrik me shpejtësi të ulët për të bërë një përzierje sa më uniforme dhe të plotë.

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit ANTI MOULD bëhet me anën e një furçe ose me anën e një rruli. Cikli i aplikimit përfshin aplikimin e së paku dy shtresave të bojës. Koha e nevojshme ndërmjet dy shtresave është 2-4 orë në varësi edhe të kushteve atmosferike, temperaturës dhe lagështisë. Pastroni furçat, rrulat dhe mjetet e tjera të punës me ujë para se boja të thahet.

PAKETIMI

Kova plastike 3lt / 10lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të mos lahen deri në 20-30 ditë pas aplikimit.
- Në sipërfaqe të betonit të freskët produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.

